INTERPRETIM SIMULTAN

Titullari /pedagoguilëndës: M.A. Ilda Themeli
Ngarkesa: 8 kredite; 80 orë mësimore; 15 leksione/65 seminare;
Tipologjia e lëndës: B
Viti akademik: 2023 - 2024/semestri II
Llojiilëndës: Lëndë e detyrueshme
Programiistudimit: Bachelor në Përkthim dhe Interpretim
Adresa elektronike e titullarit /e pedagogut të lëndës: ilda.themeli@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT*:*

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon njohjen e domosdoshme teorike të nevojshme për realizimin e interpretimit simultan. Nëpërmjet simulimit të konferencave kryesisht ushtrimin në seanca praktike të interpretimit simultan lënda synon përvetësimin dhe ushtrimin e shprehive të nevojshme bazë dhe zotërimin e mekanizmave të nevojshëm logjikë e teknikë për realizimin e interpretimit simultan dhe formës së posaçme të interpretimit me pëshpëritje (chuchotage).

Kursi synon zhvillimin e kompetencës së përgjithshme të interpretimit simultan në kombinimin gjuhësor B – A dhe A – B, zhvillimin e kompetencës gjuhësore dhe teknike në fusha të ndryshme.

Kjo lëndë ka karakter profesional teorik dhe praktik që synon aftësimin e studentëve për realizimin e interpretimit simultan në kombinimin gjuhësor B – A dhe A – B.

Gjuha B është gjuha e parë e huaj nga e cila dhe drejt të cilës realizohet interpretimi (në kuptimin e këtij programi gjuhë B konsiderohet gjuha gjermane). Gjuha A është gjuha amtare (në kuptimin e këtij programi gjuhë A konsiderohet gjuha shqipe.

Objektivat specifike lëndore:

- të realizohet me saktësi e plotësi kuptimore interpretimi simultan nga gjuha B drejt gjuhës A duke ruajtur nuancat stilistikore dhe me natyrë prozodike si dhe duke realizuar një interpretim korrekt nga pikëpamja gramatikore.

- të realizohet me saktësi e plotësi kuptimore interpretimi simultan nga gjuha A drejt gjuhës B duke ruajtur nuancat stilistikore dhe me natyrë prozodike si dhe duke realizuar një interpretim korrekt nga pikëpamja gramatikore.

- Lënda kontribuon në rritjen e kompetencës gjuhësore në gjuhën B si dhe në rritjen e aftësisë së studentëve për punë të pavarur me lloje të ndryshmel igjërimesh.

Kursi do të dominohet nga seancat praktike simuluese të konferencave duke ndjekur vijën e progresonit pedagogjik. Sa i përket tematikave të interpretimit simultan përzgjidhen një larmi temash konferencash, të përshtatura për nga shkalla e vështirësisë terminologjike dhe të ritmit të referimit sipas qëllimeve konkrete didaktike e metodologjike. Në lidhje me interpretimin simultan do të ndiqet progresioni didaktik duke filluar ushtrimin e kësaj forme të interpretimit me ligjërime të njohura nga ushtrimet e konsekutivit, duke vazhduar me simultanin me ritme të

ngadalta dhe simultanin me ritme të shpejta. Sa i përket përvetësimit të normave deontologjike kursi do të integrojë lojë me role për ilustrimin e normave dhe diskutim të tyre gjatë interpretimit të studentëve.